



## RAPORT I VITIT 2023 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E DREJTËSISË

### *1. Përmbledhje ekzekutive*

Gjatë vitit 2023, Ministria e Drejtësisë ka përmbushur në masën 100% detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt i ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Konkretisht janë konsultuar nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe aktiviteteve të tjera konsultative:


- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 ‘Për policinë e burgjeve’”;
- Projektligji “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”;
- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi procedurës penale i republikës së shqipërisë”, të ndryshuar”;
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””;
- Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”.
- Projektvendimi “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”.

Realizimi i procesit të konsultimit publik për vitin 2023 është 100%.

Procesi i Konsultimit Publik krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar, format e përzgjedhura të konsultimit kanë rezultuar efektive duke mundësuar mbledhjen dhe reflektimin e reagimeve të palëve të interesit në draftin përfundimtar më qëllim krijimin e një ligji të gjithëpranuar dhe që reflekton interesin e publikut. Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimarrjes nëpërmjet procesit të konsultimit publik mbetet sfida për t’u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë në të ardhmen.

*Fig.1: Projektakte të konsultuara gjatë vitit 2023*

## Projektakte të konsultuara gjatë vitit 2023



## 2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë vitit 2023

### 2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

#### 2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i përgjithshëm i akteve të miratuara nga Ministria e Drejtësisë për vitin 2023 është 32 akte.

#### 2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

6 (gjashtë) akte janë miratuar për vitin 2023, të cilat i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik. Në lidhje me pjesën tjetër të akteve të cilat janë miratuar, konkretisht 26 prej tyre, nuk kanë qenë objekt i konsultimit publik në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

#### 2.1.3 Sa ligje me raport VNR-je janë konsultuar?

- Projektligji “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”, i cili i është nënshtruar procesit të konsultimit gjatë periudhës Janar-Qershor 2023, është shoqëruar nga raporti përkatës VNR.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””, është shoqëruar nga raporti përkatës VNR.
- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi procedurës penale i republikës së shqipërisë”, të ndryshuar” nuk i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45 të rregullores së Këshillit të Ministrave.

#### 2.1.4 Për sa akte në a) Program Analitik, PKIE, Dokumenta strategjik janë përdorur kriteret përjashtuese nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse do të kishte të tilla)

Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektdokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, dhe për pasojë nga ana jonë konsultimi publik është parashikuar të realizohet vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t’iu

nënshtuar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1 të ligjit të lartpërmendur. Ndërsa në nenin 4 të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” është parashikuar lista e projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, siç janë çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të KM me fuqinë e ligjit, emergjenca civile dhe çështje të tjera të parashikuara me ligj.

Janë planifikuar për konsultim publik vetëm projektligjet dhe projektdokumentat strategjikë duke përjashtuar projektvendimet në përputhje kjo me parashikimet e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.862/2022 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023”, për vitin 2023 janë parashikuar të miratohen 19 akte, ku 8 prej tyre përjashtohen nga detyrimi për t’iu nënshtuar procesit të konsultimit publik, pasi konsiderohen si akte administrative individuale dhe akte administrative me karakter normativ. Aktet të cilat janë përjashtuar nga detyrimi për t’iu nënshtuar procesit të konsultimit publik nuk kanë qenë të parashikuar në PKIE apo të kenë lidhje me strategjitë kombëtare dhe sektoriale.

*2.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, rregullore ministrore, etj.)?*

Aktet e miratuara objekt i konsultimit publik gjatë vitit 2023, janë 4 (katër) projektligje, konkretisht projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 ‘Për policinë e burgjeve’”, projektligji “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”, projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi procedurës penale i republikës së shqipërisë”, të ndryshuar”, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””; dhe 2 (dy) projektvendime, konkretisht projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”, si dhe Projektvendimi “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”.

*Fig.2: Projektakte të konsultuara gjatë vitit 2023, sipas përfshirjes në PPAP*



## 2.2. Metodat e konsultimit

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3 (tre):

1. Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik;
2. Përcjellja e komenteve në rrugë postare dhe nëpërmjet postës elektronike të koordinatorit për konsultimin publik;
3. Tryeza konsultimi të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.

*2.2.1 Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistrin elektronik, postën elektronike, faqet e internetit, takimet publike, komitetet këshilluese, etj.)*

- Projektligji “Për disa dhe shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 “Për policinë e burgjeve” u konsultua përmes konsultimit në faqen zyrtare të konsultimit publik.


- Projektligji “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”, u konsultua në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” si dhe u zhvilluan takime në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.

- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi procedurës penale i republikës së shqipërisë”, të ndryshuar”, u konsultua përmes konsultimit në faqen zyrtare të konsultimit publik.

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””, u konsultua në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” si dhe janë zhvilluar takime me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.

- Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”, u konsultua në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike”, janë zhvilluar takime me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe u bë publike nga Ministri i Drejtësisë edhe nëpërmjet medias.

- Projektvendimi “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”, u konsultua në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” si dhe janë zhvilluar takime me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.



*Fig. 3: Metodat e konsultimit publik*

Pra, 100% e akteve të planifikuara gjatë vitit 2023 u konsultuan nëpërmjet Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

### *2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Në lidhje me aktet të cilat janë konsultuar gjatë vitit 2023, metodat të cilat kanë gjeneruar numrin më të madh të komenteve kanë qenë takimet e zhvilluara me grupet e interesit, institucionet e ndryshme, komunikimet elektronike si dhe faqja e zyrtare e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

- Lidhur me projektligjin “Për disa dhe shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 “Për policinë e burgjeve” nuk ka grupe interesi të cilat mund të përfshiheshin në tryeza apo aktivitete të ngjashme pasi subjekti i interesuar është vetë Policia e Burgjeve e cila është strukturë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve e cila ka kërkuar ndërmarrjen e kësaj nisme.

Persona të interesuar lidhur me këtë nismë janë gjithashtu qytetarët, të cilët mund të shfaqin interes për të aplikuar si kandidatë për punonjës të Policisë së Burgjeve, të cilët janë informuar nëpërmjet konsultimit publik dhe vlerësohet si mjet i mjaftueshëm për informimin e publikut mbi lehtësimin e kushteve pranuese. Për rrjedhojë nuk ka pasur komente të cilat janë gjeneruar nëpërmjet dy metodave të konsultimit.

- Lidhur me projektligjin “Për Arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”, metodat e konsultimit publik të përdorura kanë qenë si vijon:

a.Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 12.12.2019-13.01.2020 dhe 18.08.2020-15.09.2020.

b.Tryeza konsultimi të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.

Aktivitetet e realizuara:

16 Shtator 2019, Ministria e Drejtësisë: takim me pjesëmarrës punonjës të Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësues nga të gjitha Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë në vend, përfaqësues nga zyra avokatie dhe nga organizatat jofitimprurëse me fushë veprimi që ndërlidhet me arbitrazhin.

21 Nëntor 2019, Ministria e Drejtësisë: tryezë paraprake konsultimi në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës specialistë përgjegjës dhe me ekspertë të Euralius për përgatitjen e një drafti paraprak.

3 Shkurt 2020- Tryezë Konsultimi në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës përfaqësues nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit të MD-së dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë.

28 Shkurt 2020- Tryezë konsultimi të zhvilluar në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës përfaqësues nga ICC Albania, ekspertë të fushës dhe përfaqësues nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit të MD-së.

3 Mars 2020- Tryezë konsultimi të zhvilluar në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës përfaqësues nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit të MD-së dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë.

19 Tetor 2020- Tryezë konsultimi në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës përfaqësues nga ICC Albania, ekspertë të fushës dhe përfaqësues nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit të MD-së.

- Në lidhje me projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi procedurës penale i republikës së shqipërisë”, të ndryshuar”, është përdorur metoda e konsultimit në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 13.09.2022-10.10.2022, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente.

-Aktivitetet e realizuara:

Projektligji si dhe relacioni shpjegues janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Mbledhjet e kontributeve në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës zyrtare drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë.

- Në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””, metodat e konsultimit publik të përdorura kanë qenë si vijon:

a. Njoftimi paraprak mbi ndryshimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i publikuar në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 27.06.2022 – 25.07.2022, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente. Me shkresën nr.

3678 prot., datë 04.06.2022, njoftimi paraprak i është dërguar nominalisht edhe disa prej organizatave kryesore të shoqërisë civile, si dhe atyre me fokus median dhe gazetarinë. Pas këtij njoftimi, 5 organizata të shoqërisë civile kanë dërguar opinionet dhe propozimet e tyre, të cilat janë mbajtur në konsideratë gjatë hartimit të projektligjit.

b. Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 19.10.2022 – 15.11.2022, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente përmes këtij protali, por në rrugë postare në adresën e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në adresën e e-mailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin.

Aktivitetet e realizuara:

Maj 2022 - identifikimi i grupeve të interesit, përzgjedhja e metodave të konsultimit, nga struktura përgjegjëse për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit””.

27 qershor 2022 – 25 korrik 2022, publikohet njoftimi paraprak në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike”, si dhe me shkresën nr. 3678 prot., datë 04.06.2022, ftohen organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit që të paraqesin:

- çdo informacion ose opinion paraprak për çdo çështje apo problematikë me të cilën janë hasur gjatë zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit,
- propozime konkrete për ndryshime në ligj me qëllim adresimin e këtyre çështjeve
- informacione ose opinione të tjera që vlerësojnë se i shërbejnë përmirësimit të ligjit për të drejtën e informimit, garantimit të së drejtës për informim dhe rritjes së nivelit të transparencës së autoriteteve publike.

19 tetor 2022 – 15 nëntor 2022 Projektligji, në zbatim të ligjit 146/2014, i nënshtrohet procesit të konsultimit në portalin e “Regjistrin elektronik për Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike”

Projektligji, relacioni shpjegues, si dhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe nëpërmjet adresës së e-mailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Më datë 11.04.2023 është organizuar takimi konsultativ nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me përfaqësues të shoqërisë civile dhe medias.

- Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”, metodat e përdorura për konsultim kanë qenë si vijon:

Strategjia së bashku me dokumentat e saj strategjike u hartuan përmes një procesi planifikimi, duke përfshirë përfaqësuesit e institucioneve të ekzekutivit në nivel vendor dhe qendror, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe partnerët ndërkombëtarë, veprimtaria e të cilëve lidhet me mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit, duke siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent. Paketa u dërgua tek të gjithë institucionet, partnerët vendas ndërkombëtare nëpërmjet rrugëve elektronike/ e-mail, në rrugë zyrtare shkresore, publikim/njoftim në faqen

ëeb të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe u bë publike nga Ministri i Drejtësisë edhe nëpërmjet medias.

Janë zhvilluar gjithësej 8 (tetë) takime:

1. 20.02.2023 Takim i organizuar në kuadër të Ditës Evropiane për Viktimat e Krimit. Ministri i Drejtësisë, z. Ulsi Manja, në këtë takim lançoi fillimin e procesit të hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030 në kuadër të procesit të integritit të Shqipërisë në BE.
2. 30.03.2023 Takim konsultativ me Organizatën e Shoqërisë Civile EMA dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë me temë “Nevoja për miratimin e një Strategjie Kombëtare për Mbrojtjen/Të Drejtat e Viktimave të Krimit”.
3. 12.05.2023 Takim me Grupin Ndërinstitucional të Punës, i organizuar pranë Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me Urdhrin nr.50, datë 05.04.2023, të Kryeministrit “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”. Në takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve të administratës publike, institucioneve të pavaruara, Organizatat e Shoqërisë Civile, si dhe ekspertë ndërkombëtarë, të cilët do të asistojnë Ministrinë e Drejtësisë në këtë proces të rëndësishëm.
4. 30.05.2023 Takim me Grupin Ndërinstitucional të Punës, i organizuar pranë Ministrisë së Drejtësisë, me përfaqësues të Grupit Ndërinstitucional të Punës me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile, me fokus mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit, si dhe me ekspertë që kanë asistuar Sekretariatit Teknik të Ministrisë së Drejtësisë, për hartimin e paketës strategjike të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030. Në këtë takim u prezantuan dhe u diskutuan gjetjet e Raport-Analizës së situatës mbi viktimat e krimit në Shqipëri, metodologjisë ku bazohet hartimi i Strategjisë dhe u propozuan nga anëtarët e GNP-së masa që synojnë forcimin dhe mbrojtjen e viktimave.
5. 12.06.2023 Takim me Grupin Ndërinstitucional të Punës, i organizuar pranë Ministrisë së Drejtësisë, me përfaqësues të Grupit Ndërinstitucional të Punës, me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile, me ekspertë që kanë asistuar Sekretariatit Teknik të Ministrisë së Drejtësisë, për hartimin e paketës strategjike të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030. Në këtë takim u prezantuan dhe u diskutuan gjetjet e Raport-Analizës së situatës mbi viktimat e krimit në Shqipëri, metodologjisë ku bazohet hartimi i Strategjisë dhe u propozuan nga anëtarët e GNP-së masa që synojnë forcimin dhe mbrojtjen e viktimave.
6. 19.06.2023 Takim konsultativ i organizuar pranë Tirana International Hotel, me mbështetjen e projektit JUSTAL, ku morën pjesë përfaqësues të Sekretariatit Teknik të Ministrisë së Drejtësisë dhe ekspertë të cilët kanë asistuar Ministrinë e Drejtësisë për hartimin e strategjisë si dhe përfaqësues të NJMF dhe KVDHF të Bashkisë Tiranë, për të dhënë kontributin e tyre mbi këtë strategji. Takimi u zhvillua në kuadër të hartimit të SNMVK 2024-2030, në formën e një ëorkshop-i, ku u konsultuan, u vlerësuan dhe u parashikuan masa dhe aktivitete të propozuara nga institucionet bazuar në gjetjet e Raport-Analizës së situatës mbi viktimat e krimit në Shqipëri.
7. 20.06.2023 Takim konsultativ i organizuar pranë Tirana International Hotel, me mbështetjen e projektit JUSTAL, ku morën pjesë përfaqësues të Sekretariatit Teknik të Ministrisë së Drejtësisë dhe ekspertë të cilët kanë asistuar Ministrinë e Drejtësisë për hartimin e strategjisë. Takimi u zhvillua në kuadër të hartimit të SNMVK 2024-2030, në formën e një ëorkshop-i, ku u konsultuan, u vlerësuan dhe u parashikuan masa dhe aktivitete të propozuara



nga institucionet bazuar në gjetjet e Raport-Analizës së situatës mbi viktimat e krimit në Shqipëri.

8. 27.06.2023 Takim konsultativ i organizuar pranë Tirana International Hotel, me mbështetjen e projektit JUSTAL, ku morën pjesë përfaqësues të Sekretariatit Teknik të Ministrisë së Drejtësisë dhe ekspertë të cilët kanë asistuar Ministrinë e Drejtësisë për hartimin e strategjisë. Takimi u zhvillua në kuadër të hartimit të SNMVK 2024-2030, në formën e një ëorkshop-i, ku u konsultuan, u vlerësuan dhe u parashikuan masa dhe aktivitete të propozuara nga institucionet bazuar në gjetjet e Raport-Analizës së situatës mbi viktimat e krimit në Shqipëri.

- Në lidhje me projektvendimin "Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës", metodat e konsultimit të përdorura kanë qenë si vijon:

Konsultimi në portalin "Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike" për periudhën 03 tetor - 30 tetor 2023, gjatë së cilës janë përcjellë komentet nga tre përfaqësues të shoqërisë civile. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare dhe elektronike. Mbledhjet e kontributeve në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës zyrtare drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

Ky Projektvendim është produkt i GNPIE për hartimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës bazuar në Urdhrin nr. 57 datë 24.04.2023 të Kryeministrit "Për disa shtesa në urdhrin nr. 94 datë 20.05.2019 të Kryeministrit, "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian".

Ky projektvendim i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimi intensiv me të gjithë institucionet kontribuese anëtare të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për hartimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës parashikuar në Urdhrin nr. 57 datë 24.04.2023 të Kryeministrit.

Në përputhje me parashikimet ligjore draft udhërrëfyesi për shtetin e së drejtës është konsultuar dhe me Platformën për Partneritetin për Integrimin Evropian (PPIE) dhe për këtë qëllim janë organizuar disa takime në periudhën maj – nëntor 2023, si vijon:

- Në 19 maj u mbajt takimi i parë i PPIE për konsultimin e këtij dokumenti;
- Në 14 shtator u zhvillua takimi i dytë i PPIE për konsultimin e dokumentit pas marrjes së raportit të shqyrtimit analitik për grupkapitullin e parë si pjesë dhe e konsultimit publik të dokumentit Prezantimi i Masave Prioritare të Politikave në fushën e shtetit të së drejtës nën Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore" dhe Kapitulli 24 "Drejtësi, Liri dhe Siguri". Pjesëmarrës në këtë takim ishin 9 përfaqësues nga shoqëria civile, 1 përfaqësues nga bota akademike, 2 përfaqësues nga grupet e interesit dhe 1 përfaqësues nga media.
- Një tryezë e PPIE e përbashkët dhe me Ministrinë e Brendshme dhe anëtarët e PPIE të kapitullit 23 u realizua më 5 tetor 2023 ku pjesëmarrës ishin 8 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, 2 përfaqësues të botës akademike, 1 përfaqësues nga grupet e interesit dhe 1 përfaqësues nga media.

### *2.2.3 A organizoi ministria gjithashtu disa konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Sa i përket akteve të cilave i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik gjatë vitit 2023, nuk janë zhvilluar konsultime paraprake, përveç njoftimit paraprak të realizuar në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’”.

Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit ka realizuar konsultime paraprake për projektligjin “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”. Projektakti është konsultuar me të gjitha grupet e interesit kryesisht me Dhomat e tregtisë dhe industrisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë.

Në lidhje me projektligjin “Për disa dhe shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 “Për policinë e burgjeve”, gjatë procesit të konsultimit publik nuk janë përfshirë palë të treta. Hartimi projektligjit ka kaluar vetëm përmes bashkërendimit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentit të Administratës Publike.

Në lidhje me projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’”, akti nuk është hedhur për diskutim në tryeza me aktorë apo grupe të tjerë interesi, përveç institucioneve të pavarura, nisur nga fakti se dispozita e cila amendohet është një dispozitë teknike procedurale si dhe fakti se nisma është ndërmarrë bazuar në rezultatet e Këshillimit Kombëtar ku qytetarët i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes nr. 2.

Në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit’”, njoftimi paraprak mbi ndryshimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i publikuar në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 27.06.2022 – 25.07.2022, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente. Me shkresën nr. 3678 prot., datë 04.06.2022, njoftimi paraprak i është dërguar nominalisht edhe disa prej organizatave kryesore të shoqërisë civile, si dhe atyre me fokus median dhe gazetarinë. Pas këtij njoftimi, 5 organizata të shoqërisë civile kanë dërguar opinionet dhe propozimet e tyre, të cilat janë mbajtur në konsideratë gjatë hartimit të projektligjit.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”, strategjia së bashku me dokumentat e saj strategjike u hartuan përmes një procesi planifikimi, duke përfshirë përfaqësuesit e institucioneve të ekzekutivit në nivel vendor dhe qendror, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe partnerët ndërkombëtarë, veprimtaria e të cilëve lidhet me mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit, duke siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent. Paketa u dërguar tek të gjithë institucionet, partnerët vendas ndërkombëtare nëpërmjet rrugëve elektronike/ e-mail, në rrugë zyrtare shkresore, publikim/njoftim në faqen eeb të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe u bë publike nga Ministri i Drejtësisë edhe nëpërmjet medias.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës”, projektakti është publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto

dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë shkresore dhe elektronike. Mbledhjet e kontributeve në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektvendimit, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës zyrtare drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

### 2.3.Kohëzgjatja e konsultimeve

*2.3.1Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditët e kërkuara? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes?*

Konsultimi publik ka qenë i hapur për 20 ditët e kërkuara për 6 aktet të cilat i janë nënshtruar këtij procesi gjatë vitit 2023, përveç njërit akt, konkretisht projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””. i cili ka qenë i publikuar dy herë në faqen zyrtare të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Të gjitha aktet të cilat i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik, konsultimi publik

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 ‘Për policinë e burgjeve’”

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit. Konsultimi elektronik për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 ‘Për policinë e burgjeve’”<sup>1</sup>, u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditësh pune, nga data 20.10.2022-16.11.2022.

- Projektligji “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit. Konsultimi elektronik për projektligjin “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”<sup>2</sup>, u zhvillua me kohëzgjatje prej 40 ditësh pune, nga data 12.12.2019-13.01.2020 dhe 18.08.2020-15.09.2020.

- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’”

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit. Konsultimi elektronik për këtë projektligj<sup>3</sup> u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditësh pune, nga data 13.09.2022-10.10.2022.

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””

a. Njoftimi paraprak mbi ndryshimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i publikuar në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për

<sup>1</sup> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/529>

<sup>2</sup> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/292>

<sup>3</sup> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/513>

periudhën 27.06.2022 – 25.07.2022, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente. Me shkresën nr. 3678 prot., datë 04.06.2022, njoftimi paraparak i është dërguar nominalisht edhe disa prej organizatave kryesore të shoqërisë civile, si dhe atyre me fokus median dhe gazetarinë. Pas këtij njoftimi, 5 organizata të shoqërisë civile kanë dërguar opinionet dhe propozimet e tyre, të cilat janë mbajtur në konsideratë gjatë hartimit të projektligjit.

b. Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 19.10.2022 – 15.11.2022<sup>4</sup>, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente përmes këtij protali, por në rrugë postare në adresën e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në adresën e e-mailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin.

- Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve<sup>5</sup>”

Në kuadër të transparencës dhe ligjit për konsultimin publik, paketa iu nënshtroi procesit të konsultimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve nga aktorët e interesuar në këtë proces. Draft SNMVK qëndroi e publikuar për 21 ditë kalendarike pune, nga data 30.08.2023-27.09.2023. Për konsultimin e paketës është ndjekur dhe rruga elektronike, si dhe publikimi në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, në kuadër të një procesi gjithëpërfshirës.

- Projektvendim “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës<sup>6</sup>”

Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 03 tetor - 30 tetor 2023, gjatë së cilës janë përcjellë komentet nga tre përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Mbledhjet e kontributeve në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektvendimit, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës zyrtare drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

### *2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për këtë periudhë ishte 7 (shtatë) muaj. Kjo përlllogaritje është bërë duke patur në vëmendje kohën (numrin e muajve) gjatë të cilës ka filluar puna për identifikimin e grupeve të interesit, hartimin e draftit, publikimin e tij në RENJK, marrjen dhe vlerësimin e komenteve dhe përgatitjen e një drafti final për projektaktin.

### *2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Në krahasim me vitin e kaluar situata ka pasur një rënie relativisht të dukshme të procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik rezulton të jetë në ulje. Një nga proceset që mund të përdoret me qëllim përmirësimit të kësaj situatë është zhvillimi sesioneve të ndryshme njohëse me portalin e RENJK me aktorë të ndryshëm.

<sup>4</sup> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/528>

<sup>5</sup> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/652>

<sup>6</sup> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/661>

Gjatë vitit 2023, Ministria e Drejtësisë rezulton me një shkallë realizimi të procesit të konsultimit publik 100 %, por jemi të mendimit se situata lidhur me këtë proces është përmirësuar në krahasim me vitin apo vitet paraardhëse.

Të dhënat e përftuara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se është ulur numri i vizitorëve përkatësisht 5225 për vitin 2023, ndërsa gjatë vitit 2022 numri ka qenë 10098. Gjatë vitit 2023 vihet re një interes më i ulët në lidhje me komentet e përcjella përmes platformës së regjistrimit elektronik.




Fig 4: Krahasim i numrit të vizitorëve të RENJK përgjatë vitit 2023 dhe 2022

## 2.4. Palët e interesit të përfshira

### 2.4.1 Sa palë interesi të jashtme morën pjesë në grupet e punës për hartimin e akteve gjatë vitit? Sa eksperte ishin në tryeza?

Gjatë vitit 2023 aktorët pjesëmarrës ishin kryesisht përfaqësues të institucioneve shtetërore si Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Departamentit të Administratës Publike, përfaqësuesit e institucioneve të ekzekutivit në nivel vendor dhe qendror, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Konkretisht, numri i ekspertëve të cilët kanë dhënë kontributet e tyre gjatë vitit 2023 ka qenë 12.

Një nga projektaktet konkretisht projektligji për “Arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”, është konsultuar me të gjitha grupet e interesit kryesisht me Dhomat e tregtisë dhe industrisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë.

Konkretisht, në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 ‘Për policinë e burgjeve’”, procesi i hartimit dhe bashkërendimit u shoqërua nga një komunikim shumë intensiv bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të përfshira, dhe 4 (katër) ka qenë numri i ekspertëve pjesëmarrës në grupin e punës.

Në lidhje me projektligjin “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”, projektakti është konsultuar me të gjitha grupet e interesit kryesisht me Dhomat e tregtisë dhe industrisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë.

Në lidhje me projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’”, projektakti është përcjellë pranë institucioneve të interesuara me qëllim konsultimin e tij sa më gjithëpërfshirës si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dhe Prokuroria e Përgjithshme të cilat kanë përcjellë vlerësimet e tyre në rrugë zyrtare.

Në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””, hartimi i tij ka kaluar përmes një dialogu të vazhdueshëm me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për diskutimin e problematikave dhe formulimin e parashikimeve të duhura ligjore. Projektligji është hartuar fillimisht nga Komisioneri dhe është përcjellë më pas pranë Ministrisë së Drejtësisë. Pas një vlerësimi paraprak, është publikuar/dërguar njoftimi paraprak mbi ndryshimet në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në vijim të të cilit 5 subjekteve kanë përcjellë propozimet e tyre.

Më tej, propozimet dhe sugjerimet e shoqërisë civile dhe drafti i përgatitur nga Komisioneri i është nënshtruar një vlerësimi të thelluar me qëllim adresimin e propozimeve, si dhe hartimin e projektligjit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e teknikës legjislative. Procesi i hartimit të këtij projektligji ka kaluar përmes disa ndryshimeve me qëllim reflektimin e komenteve të aktorëve të përfshirë, si dhe përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe parashikimet e tjera ligjore.

Në përfundim të këtij procesi projektligji i është nënshtruar konsultimit publik përmes publikimit të tij në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe dërgimit për mendim disa institucioneve.

Pas marrjes së mendimeve nga ana insitucioneve dhe shoqërisë civile dhe ripunimit të draftit, projektligji i është dërguar për shqyrtim përsëri shoqërisë civile, së bashku me ftesën për pjesëmarrje në takimin konsultativ të dates 11.04.2023.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”, strategjia së bashku me dokumentat e saj strategjike u hartuan përmes një procesi planifikimi, duke përfshirë përfaqësuesit e institucioneve të ekzekutivit në nivel vendor dhe qendror, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe partnerët ndërkombëtarë, veprimtaria e të cilëve lidhet me mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit, duke siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent. Paketa u dërgua tek të gjithë institucionet, partnerët vendas ndërkombëtare nëpërmjet rrugëve elektronike/ e-mail, në rrugë zyrtare shkresore, publikim/njoftim në faqen eeb të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe u bë publike nga Ministri i Drejtësisë edhe nëpërmjet medias.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës”, ky akt është produkt i GNPIE për hartimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës bazuar në Urdhrin nr. 57 datë 24.04.2023 të Kryeministrit “Për disa shtesa në urdhrin nr. 94 datë 20.05.2019 të Kryeministrit, “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian”. Ky projektvendim i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimi intensiv me të gjithë institucionet kontribuese anëtare të Grupit Ndërinstitucional të Punës për

Integrimin Evropian (GNPIE) për hartimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës parashikuar në Urdhrin nr. 57 datë 24.04.2023 të Kryeministrit.

*2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individual, OSHC, kompani, etj.)*

Për konsultimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 ‘Për policinë e burgjeve’”, nuk janë zhvilluar tryeza konsultimi me ekspertë të jashtëm, kompani, etj.

Në lidhje me projektligjin “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”, janë zhvilluar tryeza konsultimi me të gjitha grupet e interesit kryesisht me Dhomat e tregtisë dhe industrisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë.

Në lidhje me projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, nuk janë zhvilluar tryeza konsultimi me ekspertë të jashtëm, kompani, etj.

Në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””, hartimi i projektligjit ka kaluar përmes një dialogu të vazhdueshëm me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për diskutimin e problematikave dhe formulimin e parashikimeve të duhura ligjore. Projektligji është hartuar fillimisht nga Komisioneri dhe është përcjellë më pas pranë Ministrisë së Drejtësisë. Pas një vlerësimi paraprak, është publikuar/dërguar njoftimi paraprak mbi ndryshimet në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në vijim të të cilit 5 subjekteve kanë përcjellë propozimet e tyre.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”, strategjia së bashku me dokumentat e saj strategjike u hartuan përmes një procesi planifikimi, duke përfshirë përfaqësuesit e institucioneve të ekzekutivit në nivel vendor dhe qendror, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe partnerët ndërkombëtarë, veprimtaria e të cilëve lidhet me mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit, duke siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent. Paketa u dërguar tek të gjithë institucionet, partnerët vendas ndërkombëtare nëpërmjet rrugëve elektronike/ e-mail, në rrugë zyrtare shkresore, publikim/njoftim në faqen eeb të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe u bë publike nga Ministri i Drejtësisë edhe nëpërmjet medias.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës”, në përputhje me parashikimet ligjore draft udhërrëfyesi për shtetin e së drejtës është konsultuar dhe me Platformën për Partneritetin për Integrimin Evropian (PIIE) dhe për këtë qëllim janë organizuar disa takime në periudhën maj – nëntor 2023. Pjesëmarrës në takimet e zhvilluara ishin përfaqësues nga shoqëria civile, përfaqësues nga bota akademike, përfaqësues nga grupet e interesit dhe përfaqësues nga media.

*2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të bëra për projekt-akte në vitin e caktuar?*

Gjatë procesit të konsultimit publik përveç institucioneve të cilët kanë qenë të përfshirë në të, kanë dhënë komente dhe kontribute 12 grupe interesi, ku përfshihen dhe ekspertë të ndryshëm.

Hartimi projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 ‘Për policinë e burgjeve’”, ka kaluar vetëm përmes bashkërendimit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentit të Administratës Publike.

Në lidhje me projektligjin “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”, kanë marrë pjesë përfaqësues nga ICC Albania, ekspertë të fushës, si dhe përfaqësues nga Dhomat e tregtisë dhe industrisë.

Në lidhje me projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, nuk janë zhvilluar tryeza konsultimi me ekspertë të jashtëm, kompani, etj.


Në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””, janë zhvilluar një sërë tryezash konsultimi me aktorët të cilët përbëjnë dhe grupet e interesit.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”, janë zhvilluar një sërë tryezash konsultimi me aktorë të ndryshëm dhe grupet e interesit.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës”, janë zhvilluar disa takime me grupet e interesit si shoqëria civile, përfaqësues të botës akademike.



## NUMRI I KOMENTEVE NË TRYEZAT E KONSULTIMIT PËR SECILIN PROJEKTAKT



### 2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Në lidhje me aktet të cilat janë konsultuar gjatë vitit 2023 në total janë përfshirë 6 shoqata të cilat kanë dhënë kontributin e tyre dhe konkretisht:

- Lidhur me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 ‘Për policinë e burgjeve’”, nuk ka grupe interesi të cilat mund të përfshiheshin në tryeza apo aktivitete të ngjashme pasi subjekti i interesuar është vetë Policia e Burgjeve e cila është strukturë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve e cila ka kërkuar ndërmarrjen e kësaj nisme.

- Në lidhje me projektligjin “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”, është përfshirë me dhënien e komenteve respektive një shoqatë.

- Në lidhje me projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, nuk ka pasur shoqata të përfshira me qëllim kontribuimin në këtë nisëm ligjore.

- Në lidhje me Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””, janë përfshirë në dhënien e komenteve disa institucione dhe përfaqësues të shoqërisë civile, si Qendra Res Publika, Infocip dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

- Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”, janë përfshirë Shkolla e Magjistraturës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministria e Brendshme, Departamenti i Administratës Publike, Dhoma Kombëtare e Tregutisë, Tiranë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Akademia e Sigurisë, Avokati i Popullit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Kuvendi i Shqipërisë, INSTAT, Urdhëri i Punonjësit Social, Urdhëri i Psikologut, Autoriteti i Medias Audiovizive, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

- Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës”, janë përfshirë në dhënien e komenteve 3 shoqata.

#### *2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur jo gjithmonë në përmirësim. Kjo gjë konstatohet nga ulja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu, edhe një tjetër tregues rezulton dhe nga monitorimi i portalit të Regjistratit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike pasi vërehet një ulje e numrit të qytetarëve që ndjekin projektaktet e publikuara në të dhe dërgimi i komenteve përmes kësaj platforme. Megjithatë, nisur nga verifikimi i realizuar, numri total të vizitorëve për projektaktet gjatë vitit 2023 është 5225. Këto të dhëna janë trajtuar dhe grafikisht përkatësisht në figurën nr.6.

## **2.5.Rekomandimet dhe komentet e marra**

Gjatë vitit 2023 kontributet e mbledhura në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektakteve, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me anë të regjistrit elektronik në adresën <http://ëëë.konsultimipublik.gov.al>, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezat e konsultimit të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë.

*2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Përmes faqes së konsultimit publik nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nuk ka patur komente.

Për sa i përket projektligjit “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”, numri i komenteve të përcjella përmes tryezave të zhvilluara është 35, ndërkohë që në lidhje me projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, është përcjellë një koment në mënyrë shkresore.

Në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””, numri i komenteve të përcjella përmes tryezave të zhvilluara është 20.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”, numri i komenteve të përcjella përmes tryezave të zhvilluara është 63.


Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës”, numri i komenteve të përcjella përmes takimeve të realizuara, komunikimit elektronik dhe faqes zyrtare të konsultimit publik është 11.

*2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Për të 6 (gjashtë) projektaktet e konsultuara gjatë vitit 2023 numri total i komenteve të përcjella ka qenë 127 (njëqind e njëzeteshtatë), prej të cilave:

- 93 janë pranuar plotësisht
- 25 janë refuzuar plotësisht
- 9 janë pranuar pjesërisht

### Numri i komenteve të pranuar dhe të refuzuara



### *2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu, edhe nga monitorimi i portalit të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike vërehet një rritje e numrit të komenteve të përcjella nga qytetarët përmes kësaj platforme.

### *2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Asnjë raport VNR nuk është ndryshuar apo përditësuar në bazë të informacionit të marrë gjatë konsultimit publik.

## **2.6.Rezultatet e raporteve të konsultimeve**

### *2.6.1 Sa raporte konsultimesh publikoi ministria?*

Ministria e Drejtësisë ka hartuar dhe publikuar publikuar në portalin e regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK) raportin e konsultimit për 6 nga projektaktet konkretisht:

- Raport konsultimi për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 ‘Për policinë e burgjeve’”;
- Raport konsultimi për projektligjin “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”;
- Raport konsultimi për projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”;
- Raport konsulimi për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””;
- Raport konsulimi për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimtimit dhe të pasaportës së treguesve”;
- Raport konsultimi për projektvendimi “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës”.

### *2.6.2 Nëse disa nuk u botuan, cilat janë arsyet?*

Për vitin 2023 Ministria e Drejtësisë ka hartuar raporte konsultimi për të gjitha projektaktet për të cilat ishte planifikuar procesi i konsultimit publik, ku 6 (gjashtë) prej tyre janë publikuar në portalin e regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK).

**2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik** (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve)

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 ‘Për policinë e burgjeve’” 8;
- Projektligji “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë” 8;
- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi procedurës penale i republikës së shqipërisë”, të ndryshuar” 7.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”” 8;
- Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve” 8.
- Projektvendimi “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës” 8.

Institucioni vlerëson se konsultimi i këtyre projektakteve ka qenë në nivel shumë të mirë. Për këto projektakte janë përdorur dy metoda të konsultimit publik përkatësisht, publikimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, tryezave të ndryshme me grupet e interesit apo dhe bashkërendimet me institucionet përkatëse nëpërmjet rrugës postare.

### *3. Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësitë për të ardhmen*

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet qartësisht një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Megjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Drejtësisë, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik.